



Raporti i Transparencës 2025

RSM Kosovo sh.p.k.

PËRMBAJTJA

	Faqe
<u>Mesazh nga Partneri Menaxhues</u>	3
<u>Struktura ligjore dhe pronësia</u>	4
<u>Rrjeti i RSM International</u>	8
<u>Sistemi i kontrollit të brendshëm</u>	11
<u>Edukimi i vazhdueshëm profesional, rekrutimi dhe zhvillimi personal</u>	21
<u>Kompensimi i partnerëve</u>	23
<u>Auditimi i subjekteve me interes publik</u>	24
<u>Shënimet financiare</u>	25
<u>Shtojcat</u>	26



Mesazh nga partneri menaxhues

RSM Kosovo Sh.p.k me kënaqësi paraqet Raportin e Transparencës për vitin financiar që përfundoi më 31 dhjetor 2025 i cili është përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 06/ L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 3 i datës 19 Prill 2018.

Në vitin 2025, RSM Kosovo ka vazhduar të adresojë kërkesat dhe sfidat në rritje që lidhen me cilësinë e auditimit, në një mjedis të ndikuar nga ndryshimet rregullatore, digjitalizimi dhe përdorimi gjithnjë e më i madh i të dhënave në proceset financiare. Këto zhvillime kanë ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si zhvillohen auditimet, duke e bërë të domosdoshëm forcimin e gjykit profesional dhe përdorimin më efektiv të teknologjisë në mbështetje të proceseve të auditimit.

Një nga zhvillimet kryesore të këtij viti ka qenë rritja e përdorimit të mjeteve për analizën e të dhënave në procedurat e auditimit. Kjo ka kërkuar zhvillim të vazhdueshëm të aftësive të ekipeve tona, përmirësim të dokumentimit të evidencës së auditimit dhe forcim të kontrollit të cilësisë mbi rezultatet e nxjerra nga këto mjete. Në të njëjtën kohë, kemi kushtuar më shumë vëmendje vlerësimit të rreziqeve në mjedise financiare gjithnjë e më të automatizuara.

Si pjesë e rrjetit global RSM, ne kemi akses në metodologji dhe teknologji të avancuara, të cilat gjatë këtij viti janë mbështetur me trajnime të dedikuara dhe me rishikime teknike më të thelluara për angazhimet ku përdoren analiza të bazuara në të dhëna dhe procese të automatizuara.

Një fokus i rëndësishëm gjatë vitit ka qenë edhe vlerësimi i rreziqeve që lidhen me përdorimin e inteligjencës artificiale dhe automatizimit në proceset financiare të klientëve.

Kjo ka ndikuar në mënyrën se si planifikojmë dhe realizojmë procedurat e auditimit, duke kërkuar më shumë skepticizëm profesional dhe teste të synuara për të siguruar besueshmërinë e informacionit financiar.

Në përmbyllje, ne besojmë se zhvillimi teknologjik duhet të shoqërohet gjithmonë me standarde të larta profesionale dhe përkushtim ndaj cilësisë. Falënderojmë stafin tonë për profesionalizmin, angazhimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm gjatë gjithë vitit. Një falënderim i veçantë shkon edhe për klientët dhe bashkëpunëtorët tanë për besimin, partneritetin dhe mbështetjen e vazhdueshme, të cilat mbeten thelbësore në arritjen e objektivave tona dhe në përshtatjen ndaj ndryshimeve që po formësojnë profesionin e auditimit.

Visar Morina
Partner Menaxhues

30 prill 2026

Struktura Ligjore dhe Pronësia

RSM Kosovo SH.P.K. ("Kompania") është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Republikën e Kosovës më 18 Prill 2016 me numër unik identifikues 810861254. Adresa e regjistruar e selisë është Rruga Xhevdet Doda Dukagjini Residence, Hyrja B-C, Kati 2, nr. B56, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Më 31 dhjetor 2025, kompania punëson gjithsej 33 punonjës profesionistë, prej të cilëve gjashtë janë të angazhuar me orar të shkurtuar. Punonjësit e kompanisë janë të kualifikuar dhe kanë përvojë shumëvjeçare profesionale.

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, struktura e pronësisë është si vijon:

- Sadik Berisha – Auditor Ligjor, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 51%,
- Kujtim Berisha – individ, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 48%, dhe
- Valbona Hamiti – Auditor Ligjor, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 1%.


Përderisa Bordi i Partnerëve dhe Drejtorëve të Kompanisë është në përbërje si në vijim:

- Visar Morina – Partner Menaxhues,
- Sadik Berisha – Kryesues i bordit,
- Kujtim Berisha – Anëtar i bordit,
- Valbona Hamiti – Anëtar bordi,



Vlerat tona

Çdo vendim që marrim mbështetet në vlerat tona, të cilat janë baza e gjithçkaje që bëjmë:



RESPEKT DHE INTEGRITET I PAKOMPROMIS

Ne bëjmë gjithmonë gjënëe duhur, duke e dëshmuar atë përmes veprimeve tona.



SUKSES SË BASHKU

Ne vlerësojmë përfshirjen dhe individualitetin, duke bashkëpunuar në mënyrë efektive për të ndërtuar marrëdhënie të forta, të mbështetura në mirëkuptim të ndërsjellë dhe besim.



EKSELENCË

Ne fokusohemi vazhdimisht në cilësi dhe përpqemiti të jemi më të mirët në gjithçka që bëjmë, si individë ashtu edhe si ekip.



INOVACION ME NDIKIM

Ne mirëpresim ndryshimin dhe shfrytëzojmë njohuritë dhe teknologjinë për të sjellë një ndikim të vërtetë për klientët dhe njerëzit tanë.



VEPRIM ME PËRGJEGJËSI

Ne ndërtojmë një të ardhme më të mirë duke vepruar me përgjegjësi ndaj njerëzve tanë, klientëve, komunitetit dhe planetit.

Qasja jonë

Të gjithë klientët tanë kërkojnë standarde të larta, të ofruara përmes një qasjeje me kosto efektive. Ne krenohemi me ofrimin e shërbimeve profesionale dhe efikase, duke nxitur bashkëpunim afatgjatë dhe marrëdhënie me vlerë të ndërsjellë me klientët tanë dhe këshilltarët e tyre.


Qëllimi ynë është të zhvillojmë bashkëpunime afatgjata me klientët tanë, këshilltarët dhe palët e interesit me të cilët punojmë.

Qasja jonë bazohet në:

- ofrimin e shërbimeve me standarde të larta profesionale;
- përshtatjen fleksibile ndaj nevojave të klientëve;
- ruajtjen e pavarësisë së plotë institucionale; dhe
- ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata të bazuara në besim dhe bashkëpunim me klientët dhe këshilltarët tanë.

Ne kemi zhvilluar një gamë të gjerë dhe fleksibile aftësish, të cilat na mundësojnë të krijojmë vlerë të shtuar në punën e klientëve tanë, duke:

- dëgjuar me kujdes klientët, kuptuar objektivat e tyre dhe ofruar zgjidhje efektive e inovative;
- angazhuar një ekip profesional, nën drejtimin e një partneri, të përzgjedhur sipas nevojave specifike të klientit, si dhe duke e përshtatur dhe zhvilluar atë gjatë gjithë bashkëpunimit;
- respektuar në mënyrë të vazhdueshme afatet dhe kërkesat e raportimit; dhe
- ofruar tarifa të drejta me një strukturë fleksibile faturimi, duke mbështetur zgjidhje me kosto efektive.



Fuqia e të Qenurit të Kuptuar / The Power of Being Understood

Fuqia e të Qenurit të Kuptuar" është një premtim që u bëjmë klientëve dhe njerëzve tanë: se kur punojnë me RSM, ata bashkëpunojnë me profesionistë që marrin kohën për t'i kuptuar në thellësi, ofrojnë ide dhe njohuri të përshtatura sipas rrethanave të tyre dhe i mbështesin në marrjen e vendimeve të sigurta për të ardhmen.

Për të krijuar përvoja që na dallojnë nga të tjerët, ne në RSM inkurajojmë dhe vlerësojmë sjelljet thelbësore të njerëzve tanë si vijon:

Përkujdesjen

Ne tregojmë kujdes të sinqertë dhe mirëkuptim ndaj klientëve dhe kolegëve tanë, duke mbështetur nevojat dhe sfidat e tyre unike.

Kureshtjen profesionale

Ne bëjmë pyetje të rëndësishme dhe kërkojmë këndvështrime të ndryshme për të kuptuar më mire situatat, për të sfiduar mënyrën si mendojmë dhe për të gjeneruar ide të reja.

Bashkëpunimin

Ne bashkëpunojmë ngushtë me të tjerët, ndajmë njohuri dhe krijojmë marrëdhënie të qëndrueshme për të arritur rezultate të përbashkëta.

Guximin

Ne marrim iniciativë, sfidojmë status quo-në dhe veprojmë me integritet, edhe në situata vështira duke bërë zgjedhjet e duhura.

Mendimin Kritik

Ne analizojmë me kujdes situatat, bëjmë pyetje të menduara dhe marrim vendime të bazuara në të dhëna që sjellin vlera afatgjatë.

Rrjeti RSM International

RSM është një rrjet ndërkombëtar i firmave profesionale të pavarura, i themeluar në fillim të viteve 1960.

RSM International Limited është një kompani e kufizuar me garanci, e regjistruar në Angli dhe Uells (numri i kompanisë: 4040598), me seli të regjistruar në 200 Aldersgate Street, London, EC1A 4HD, United Kingdom.

RSM International Limited nuk ofron vetë shërbime profesionale për klientët, por vepron si një organizatë koordinuese për firmat anëtare. Shërbimet për klientët ofrohen nga firmat anëtare të pavarura të RSM International, ku secila prej tyre është një entitet juridik i veçantë dhe i pavarur. Firmat anëtare nuk janë pjesë e një partneriteti ndërkombëtar dhe nuk kanë marrëdhënie juridike partneriteti me njëra-tjetrën. Asnjë firmë anëtare nuk mban përgjegjësi për shërbimet ose veprimet e një firme tjetër anëtare. Edhe pse të gjitha firmat anëtare përdorin emrin RSM, nuk ka pronësi e përbashkët midis tyre dhe as nuk janë në pronësi të RSM International Limited.

Brendi dhe marka tregtare RSM, së bashku me të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale të përdorura nga anëtarët e rrjetit, janë në pronësi të RSM International Association, një shoqatë e themeluar sipas nenit 60 të Kodit Civil Zvicëran, me seli në Zug.

RSM Kosovo është anëtare e rrjetit RSM dhe operon nën markën RSM. RSM është një brend i përdorur nga të gjithë anëtarët e rrjetit RSM. Secili anëtar i rrjetit është një firmë e pavarur e kontabilitetit dhe konsulencës që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur.

RSM është rrjeti i gjashtë më i madh i firmave të pavarura të kontabilitetit dhe këshillimit, që përfshinë:

- firmat anëtare dhe korrespondente në 120 vende dhe janë në secilën prej 40 qendrave kryesore të biznesit në mbarë botën,
- staf të përgjithshëm prej plus 65,000 900 zyre që mbulojnë Amerikën, Evropën, Lindjen e mesme, Afrikën dhe Azinë e paqësorit.

Statistikat e RSM



65,000 njerëz në mbarë botën



900 zyra



120 shtete

Kërkesat e firmave anëtare

Firmat anëtare të RSM bien dakord të miratojnë dhe zbatojnë politikat dhe procedurat e mëposhtme si kusht për anëtarësim:

- Metodologjinë RSM Orb;
- Politikat dhe procedurat e RSM për sigurimin e cilësisë dhe menaxhimin e rrezikut;
- Politikat e Etikës dhe Pavarësisë së RSM;
- Politikat dhe udhëzimet e programit të inspektimit të firmave anëtare të RSM;
- Politikat për Trajnimin dhe Zhvillimin Profesional të Vazhdueshëm (CPD) për shërbimet e sigurimit të RSM;
- Politikat dhe udhëzimet kundër korrupsionit dhe ryshfetit të RSM;
- Politikat e sigurisë së IT-së dhe privatësisë së të dhënave të RSM.

Angazhimi i RSM International për cilësinë

Për të siguruar vëmendjen dhe kohën e nevojshme për çështjet e cilësisë, dhe për të garantuar ofrimin e shërbimeve profesionale me cilësi të lartë dhe të njëtrajtshme, Bordi Ndërkombëtar i RSM ka themeluar Komitetin Global të Cilësisë ("GQC"). GQC, si nënkomitet i Bordit Ndërkombëtar të RSM, vepron si organ mbikëqyrës dhe këshillimor, që jep rekomandime për Bordin për shqyrtim dhe miratim përfundimtar. GQC nuk ushtron funksione menaxheriale, të cilat mbeten përgjegjësi e CEO-së Ndërkombëtar të RSM, zyrtarëve dhe anëtarëve të tjerë të menaxhmentit të lartë.

Sipas mandatit të tij, Komiteti Global i Cilësisë (GQC), anëtarët e të cilit emërohen nga Bordi Ndërkombëtar i RSM, përbëhet nga pesë deri në nëntë partnerë ose profesionistë të kualifikuar dhe me përvojë nga firmat anëtare të RSM. Përbërja e GQC është e strukturuar për të siguruar përfaqësim nga të gjitha rajonet e rrjetit RSM.

Kryetari i GQC zgjidhet nga Bordi Ndërkombëtar i RSM nga radhët e anëtarëve të GQC dhe shërben për një mandat trevjeçar, me mundësi rizgjedhjeje në përfundim të tij. Anëtarët aktualë të GQC vijnë nga firmat anëtare të RSM në Australi, Afrikën Lindore, Gjermani, Porto Riko, Singapor, Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA. Kryetari i GQC është nga firma anëtare e RSM në Mbretërinë e Bashkuar.


Çdo firmë anëtare është e detyruar të krijojë një proces monitorimi, i cili synon t'i ofrojë siguri të arsyeshme se politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e kontrollit të cilësisë për shërbimet e sigurimit dhe shërbimet e tjera profesionale janë të përshtatshme, të mjaftueshme, funksionojnë në mënyrë efektive dhe janë në përputhje si me pritshmëritë e RSM, ashtu edhe me kërkesat përkatëse të përcaktuara nga bordet e standardeve të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).

Politikat e Etikës dhe Pavarësisë

RSM ka politika të etikës dhe pavarësisë, të cilat të gjitha firmat anëtare janë të detyruara t'i adoptojnë. Këto politika ndihmojnë për të siguruar që firmat anëtare, partnerët dhe punonjësit profesionalë të përmbushin kërkesat e etikës dhe pavarësisë të përcaktuara nga Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Kontabilistët Profesionalë i Bordit Ndërkombëtar të Standardeve Etike për Kontabilistët (IESBA), përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë.

Çdo firmë anëtare ka një drejtues për etikën dhe pavarësinë – një partner (ose rol ekuivalent), i cili është përgjegjës për përmirësimin dhe zbatimin e këtyre politikave sipas nevojës. Kjo përfshin sigurimin që firma të pasqyrojë çdo kod etik lokal shtesë ose kërkesa rregullatore që vendosin standarde më të larta se ato të përcaktuara në politikat minimale të etikës dhe pavarësisë së RSM.

RSM ka një Komitet Global të Pavarësisë (GIC) i përbërë nga përfaqësues të firmave anëtare dhe anëtarë të Zyrës Ekzekutive Globale (GEO). GIC i ofron kontribut GEO-së për çështjet e pavarësisë, përfshirë zhvillimin e politikave të etikës dhe pavarësisë.



Anëtarësimi në forumin e firmave

RSM është anëtare e Forumit të Firmave, një shoqatë e rrjeteve ndërkombëtare të firmave të kontabilitetit që kryejnë auditime transnacionale. RSM është aktive dhe e mbështet plotësisht objektivin e Forumit të Firmave, i cili synon të promovojë standarde të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë të raportimit financiar dhe praktikave të auditimit në mbarë botën, si dhe të mbështesë konvergencën e Standardeve Kombëtare të Auditimit me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Marion Hannon aktualisht përfaqëson RSM-në si anëtare e Komitetit të Auditorëve Transnacionalë të Forumit të Firmave.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

RSM Kosova ka hartuar, zbatuar dhe mirëmbajtur një sistem të menaxhimit të cilësisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë (ISQM 1), të nxjerrë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit dhe Sigurimit (IAASB). Ky sistem i menaxhimit të cilësisë funksionon në mënyrë të vazhdueshme dhe ciklike, duke u përshtatur me ndryshimet në natyrën dhe rrethanat e firmës, si dhe të angazhimeve të saj.

Rregullatorët dhe organet përgjegjëse për hartimin e standardeve, si në Kosovë ashtu edhe në nivel global, janë gjithashtu të fokusuar në efektivitetin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të menaxhimit të cilësisë (SQM) në firma. RSM Kosova zbaton kërkesat e ISQM 1, i cili parasheh vlerësimin vjetor të SQM-së. ISQM 1 kaprezantuar një qasje të bazuar në rrezik ndaj sistemit të menaxhimit të cilësisë, duke kërkuar që firmat të adresojnë objektivat e cilësisë dhe rreziqet që mund të ndikojnë në aftësinë për të kryer auditime me cilësi të lartë.

Një sistem i menaxhimit të cilësisë përfshin tetë komponentët në vijim:

- Procesin e vlerësimit të rrezikut të firmës anëtare;
- Qeverisjen dhe udhëheqjen;
- Kërkesat përkatëse etike;
- Pranimin dhe vazhdimësinë e marrëdhënieve me klientët dhe angazhimeve specifike;
- Kryerjen e angazhimeve;
- Burimet;
- Informimin dhe komunikimin; dhe
- Procesin e monitorimit dhe përmirësimit.

Zbatimi efektiv i ISQM 1 ka qenë dhe mbetet një element kyç i strategjisë së RSM për sigurimin e cilësisë në auditim.


Si pjesë e zbatimit të ISQM 1, objektivat e cilësisë, rreziqet e cilësisë dhe përgjigjet përkatëse janë formalizuar dhe përmbledhur në formatet e ofruara nga Zyra Ekzekutive e RSM. RSM Kosova ka përdorur të gjitha burimet e ofruara nga Zyra Ekzekutive, përfshirë:

- Një version të përditësuar të mjetit proforma për dokumentimin e objektivave, rreziqeve të cilësisë dhe përgjigjeve përkatëse brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë;

- Një mjet proforma për dokumentimin e vlerësimit vjetor në një moment të caktuar kohor, si dhe për vlerësimin e mangësive
- Rezultatet e inspektimeve të rrjetit nga cikli i vitit paraprak, të cilat janë marrë në konsideratë në raport me ndikimin e tyre në sistemin e menaxhimit të cilësisë;
- Katër kurse gjithëpërfshirëse online mbi zbatimin praktik të ISQM 1, të disponueshme për të gjitha firmat anëtare në RSM Campus, platforma jonë globale për menaxhimin e zhvillimit profesional. Këto kurse mbulojnë:
 - Hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve të monitorimit;
 - Vlerësimin e gjetjeve nga aktivitetet e monitorimit, në përputhje me kërkesat e ISQM 1 dhe politikat e RSM-së, me qëllim identifikimin e mangësive në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Më poshtë paraqitet një ilustrim grafik i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë të RSM Kosovës.



Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Qasja e udhëheqjes së lartë

Krijimi, kultivimi dhe ruajtja e një kulture respekti dhe hapjeje është pjesë thelbësore e identitetit të firmës, dhe ne mbetemi besnikë ndaj vlerave tona në vendimmarrje, angazhime dhe komunikim, si brenda ashtu edhe jashtë organizatës.

Qëndrueshmëria e këtij qasjeje vendos bazat për ofrimin e auditimeve me cilësi të lartë. Udhëheqja jonë e kupton vlerën shoqërore të një auditimi, përfitimet për palët e ndryshme të interesit, si dhe domosdoshmërinë absolute të sigurimit të cilësisë së lartë.

Njerëzit tanë përbëjnë thelbin e biznesit tonë dhe, në periudhën pas pandemisë, kemi dëshmuar forcën tonë në mbështetjen e stafit dhe partnerëve.

Ne jemi përshtatur me mënyra të reja pune dhe i kemi kushtuar vëmendje të veçantë dëgjimit të njerëzve tanë, si në mënyrë të strukturuar ashtu edhe jo të strukturuar. Motoja jonë "njerëzit në radhë të parë" na ka mundësuar jo vetëm të përballojmë sfidat, por edhe të zhvillohemi dhe të përparojmë.

Udhëheqja dhe qeverisja

Ne jemi të përkushtuar ndaj një strukture që mbështet dhe mundëson ofrimin dhe monitorimin e cilësisë së auditimit. Strukturën tonë të udhëheqjes dhe qeverisjes e rishikojmë në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që të mundësohen përmirësime paralelisht me zhvillimin e biznesit tonë, qoftë si rezultat i ndryshimeve në mjedisin rregullator, rritjes apo faktorëve të tjerë.

Politikat dhe Procedurat e etikës dhe pavarësisë

RSM Kosovo ka krijuar sisteme dhe procedura të përshtatshme për të mbështetur ruajtjen e objektivitetit të punonjësve dhe për të shmangur konfliktet e interesit, në përputhje me politikat e etikës dhe pavarësisë të zbatuara nga RSM International. Këto politika ofrojnë siguri të arsyeshme se firmat anëtare, partnerët dhe punonjësit profesionistë janë në përputhje me kërkesat e pavarësisë dhe standardet etike të:


- Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi IESBA");
- Politikat, udhëzimet dhe kërkesat ndërkombëtare të RSM International;
- Kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative lokale.

Trajnimi mbi etikën është pjesë e procedurës së induksionit për anëtarët e rinj të punonjësve.

Partnerëve dhe punonjësve profesionistë u kërkohet që çdo vit të plotësojnë një pyetësor të pajtueshmërisë me pavarësinë, i cili konfirmon se ai/ajo:

- ka lexuar politikat e etikës dhe pavarësisë së RSM-së;
- kupton zbatueshmërinë e tyre në aktivitetet e tij/saj;
- është dhe ka qenë në përputhje me këto politika gjatë vitit të kaluar.

Çdo mospërputhje me këto politika duhet të raportohet, ndërsa veprimet korrigjuese ndërmerren nga Bordi i Partnerëve.



Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Rotacioni i Partnerëve Kryesorë të Auditimit dhe Stafit

Politikat e Etikës dhe Pavarësisë të RSM përmbajnë kërkesa për rotacionin e detyrueshëm të partnerit të angazhimit në auditimet e subjekteve me interes publik, duke përcaktuar që rotacioni duhet të realizohet jo më vonë se pas shtatë vitesh nga data e emërimit të tij.

Për më tepër, këto politika ndalojnë rikthimin e partnerit në ekipin e auditimit të subjektit të audituar përpara kalimit të pesë viteve të plotë nga përfundimi i angazhimit të mëparshëm.

Politikat e Etikës dhe Pavarësisë të RSM kërkojnë gjithashtu rotacionin e detyrueshëm të Rishikuesit të Cilësisë së Angazhimit, jo më vonë se shtatë vjet nga data e emërimit të tij.

Gjithashtu, këto politika ndalojnë rikthimin e tij në auditimin ligjor të subjektit të audituar përpara kalimit të tre viteve të plotë nga përfundimi i angazhimit përkatës.

Pavarësia, marrëdhëniet dhe monitorimi i konfliktit të interesit

RSM monitoron dhe menaxhon pavarësinë, marrëdhëniet profesionale dhe konfliktet e interesit përmes përdorimit të aplikacionit RSM InTrust/GIA. Firmave anëtare u kërkohet të përdorin RSM InTrust për regjistrimin dhe monitorimin e shërbimeve të auditimit dhe jo-auditimit për kategoritë e mëposhtme:

- Subjektet me interes publik, përfshirë entitetet e listuara, subjektet private me pronarë ose bashkëpunëtorë të vendosur në juridiksione ose shtete të tjera, duke përfshirë përfituesin e fundit, kompaninë mëmë të ndërmjetme, kompanitë motra, filialet ose bashkëpunëtorët,
- grupet ose fondet e kapitalit privat.

Për më tepër, të gjithë klientët që janë filiale ose bashkëpunëtorë të grupeve që plotësojnë kriteret e mësipërme kërkohet të regjistrohen në sistemin InTrust.

Partnerëve dhe punonjësve profesionalë të firmës u kërkohet të konsultohen me sistemin InTrust dhe të ndërmarrin masa të tjera paraprake që konsiderohen të nevojshme sipas rrethanave, me qëllim sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat etike dhe politikat e pavarësisë të RSM.

RSM gjithashtu mban regjistrat e mëposhtëm:

- Pozitat e jashtme të mbajtura nga partnerët ose punonjësit, p.sh. drejtor, zyrtar, sekretar kompanie apo kujdestar;
- Të gjitha interesat financiare të firmës dhe marrëveshjet e tjera financiare;
- Të gjitha marrëdhëniet e afërta të biznesit; dhe
- Të gjitha proceset gjyqësore aktuale dhe ato të pritshme.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Procesi i zgjedhjes së konflikteve

Kur një partner i firmës anëtare ose një punonjës profesional identifikon një rrezik të mundshëm ndaj pavarësisë ose një konflikt interesi në lidhje me një klient ekzistues apo potencial të një firme tjetër anëtare, përmes kërtimeve në RSM InTrust dhe kontrolleve të tjera të konfliktit të interesit, Partneri Ndërkombëtar i Kontaktit (ICP) i firmës anëtare duhet të njoftohet.

Në rast se firmat anëtare nuk arrijnë të bien dakord për masat mbrojtëse të përshtatshme, zyra ekzekutive globale (GEO) dhe Kryetari i Bordit janë të obliguar të shqyrtojnë rrezikun e mundshëm të dëmtimit të pavarësisë ose konfliktit të interesit. Firmat anëtare duhet t'i ofrojnë GEO-së të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me faktet dhe rrethanat përkatëse, të cilat përdoren për vlerësimin e ndikimit të mundshëm në pavarësi ose konflikt interesi. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe informacionit të paraqitur, GEO dhe Kryetari i Bordit japin një rekomandim për mënyrën e zgjidhjes së çështjes së identifikuar që lidhet me pavarësinë ose konfliktin e interesit.

Pranimi dhe vazhdimi i relacioneve me klient

Sigurimi i shërbimeve të auditimit me cilësi të lartë kërkon që firmat anëtare të RSM të pranojnë vetëm klientë që ndajnë thelbin e vlerave dhe parimeve të RSM. RSM Kosovo hyn në marrëdhënie me klientë vetëm kur ata përmbushin kriteret kryesore të pranimi të RSM dhe janë të gatshëm të paguajnë një tarifë të drejtë për shërbime me vlerë të lartë profesionale.

Gjatë procesit të pranimi të klientit, partneri i angazhimit vlerëson nivelin e rrezikut të angazhimit dhe përcakton nëse kërkon kërkesa shtesë për personel, mbikëqyrje dhe rishikim të angazhimit. Në rastet kur klienti plotëson profile të caktuara të rrezikut, kërkohet miratimi i një partneri të dytë për pranimin e klientit.

Këto procedura dokumentohen në formularë të standardizuar për "Pranimin dhe Vazhdueshmërinë" e angazhimeve të auditimit.

Këta formularë janë të detyrueshëm për të gjitha angazhimet e auditimit.

Metodologjia e Auditimit – RSM Orb

RSM Orb, zgjidhja e auditimit e bazuar në rrezik e RSM, siguron që firmat anëtare të kryejnë auditime me cilësi të lartë. Ajo përbëhet nga katër elementë kryesorë:

- Metodologjia Ekskluzive Globale e Auditimit
- Manuali Global i Auditimit
- Modele të personalizuara për dokumentimin digjital të auditimit nga RSM
- Udhëzime për zbatimin praktik

Në përputhje me fokusin e RSM për arritjen e metodave dhe proceseve të unifikuara në të gjithë rrjetin, përdorimi i RSM Orb është i detyrueshëm për të gjitha auditimet e kryera nga të gjitha Firmat Anëtare. Për të mbështetur zbatimin në nivel lokal, RSM Orb është i disponueshëm në disa gjuhë, përfshirë kinezisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, rusisht dhe spanjisht.

RSM Orb u mundëson auditorëve të përqendrohen në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, si dhe të projektojnë procedura të përshtatura sipas rrethanave specifike dhe mjedisit të çdo angazhimi. Kjo qasje siguron që auditimet e RSM të jenë të qëndrueshme, inovative, të mbështetura në analizë kritike dhe të besueshme.

Si pjesë e angazhimit tonë për cilësi, RSM ka zhvilluar një program katërvjeçar trajnimi në auditim, i cili mbulon aspekte të ndryshme të metodologjisë së auditimit.

Kurrikula e trajnimit për RSM Orb përfshin 75 module dhe është e disponueshme për të gjitha Firmat Anëtare përmes RSM Campus në gjuhët anglisht dhe spanjisht. Për më tepër, Firmat Anëtare mund të zhvillojnë trajnime shtesë për të plotësuar nevojat lokale dhe për të zgjeruar më tej njohuritë përtej kurrikulës bazë.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Metodologjia e Auditimit – RSM Orb vazhdim

Gjatë vitit 2024, është pilotuar një chatbot i brendshëm i mbështetur nga inteligjenca artificiale, i cili përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e mëtejshëm të kulturës së cilësisë. Chatbot-i është zhvilluar për t'u mundësuar auditorëve qasje të shpejtë dhe kuptim më të lehtë të Manualit Global të Auditimit, duke kontribuar në rritjen e koherencës dhe besueshmërisë së shërbimeve të auditimit në nivel global.

RSM Orb përfshin gjithashtu kërkesa për:

- Rishikime të cilësisë së angazhimit
- Konsultime të detyrueshme me Udhëheqësin e Auditimit, Udhëheqësin e Etikës dhe Pavarësisë (ose përfaqësuesit e tyre), ose persona të tjerë të kualifikuar, sipas rastit.

RSM Orb është në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- Standardet Ndërkombëtare për Menaxhimin e Cilësisë (ISQM), të publikuara nga IAASB
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), të publikuara nga IAASB
- Deklaratat e Praktikës së Auditimit Ndërkombëtar (IAPS), të IAASB
- Politikat e RSM për Sigurimin e Cilësisë dhe Kufizimin e Rreziqeve

Firmat Anëtare mund të përshtatin RSM Orb për të përfshirë kërkesa shtesë që rrjedhin nga legjislacioni dhe rregulloret lokale në juridiksionin e tyre.

RSM Orb

- Metodologjia optimale e auditimit të bazuar në rrezik e RSM.
- E dizajnuar me fokus në segmentin e tregut të mesëm
- Përshtatet me kompleksitetin e klientit.
- Përqendrohet në rreziqet e klientit dhe e aftë të përshtatet ndaj rrethanave të ndryshme.
- Mundëson ofrimin e auditimeve cilësore dhe të qëndrueshme.

RSM Orb u jep mundësi Firmave Anëtare të zhvillojnë një kuptim më të thellë të klientëve të tyre, duke ofruar njohuri të rëndësishme mbi nevojat aktuale dhe të ardhshme të tyre.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Burimet Njerëzore

Firma ka zhvilluar dhe zbatuar politika dhe procedura të strukturuar për menaxhimin e burimeve njerëzore, me qëllim mbështetjen dhe sigurimin e cilësisë së lartë në ofrimin e shërbimeve profesionale. Këto politika dhe procedura synojnë të garantojnë që personeli i angazhuar të posedojë kualifikimet, kompetencat dhe përkushtimin e nevojshëm ndaj standardeve profesionale dhe parimeve etike. Objektivat kryesore:

- **Rekrutimi i stafit të kualifikuar:** Sigurimi që individët e punësuar posedojnë aftësitë, njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për të përmbushur detyrat profesionale në mënyrë efektive dhe në përputhje me standardet e kërkuara.
- **Zhvillimi profesional i vazhdueshëm:** Ruajtja dhe avancimi i kompetencave profesionale përmes trajnimeve të rregullta, edukimit profesional të vazhdueshëm dhe vlerësimit të njohurive.
- **Përputhshmëria me standardet e cilësisë dhe etikës:** Sigurimi që të gjitha proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore zhvillohen në përputhje me kërkesat e standardeve profesionale, legjisllacionit në fuqi dhe parimeve përkatëse etike.

Procedurat e zbatuara përfshijnë:

- **Planifikimi i nevojave për punësim:** Identifikimi i pozicioneve të nevojshme dhe përcaktimi i kriterëve dhe kërkesave për procesin e rekrutimit.
- **Metodat e rekrutimit dhe vlerësimi i kandidatëve:** Përdorimi i metodave të strukturuar për identifikimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm.
- **Emërimi i personave përgjegjës për procesin e punësimit:** Caktimi i personelit të autorizuar dhe kompetent për administrimin dhe mbikëqyrjen e procesit të rekrutimit.

- **Verifikimi i efektivitetit të punësimit:** Monitorimi i pajtueshmërisë me procedurat e përcaktuara dhe vlerësimi i performancës dhe integritetit të stafit të ri në organizatë.
- **Përcaktimi i kualifikimeve dhe përgjegjësi sipas niveleve profesionale:** Hartimi i profileve të qarta për secilin nivel profesional, duke përfshirë detyrat, përgjegjësitë, kompetencat dhe kërkesat për ekspertizë profesionale.



Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Monitorimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë

Qëllimi i monitorimit është të sigurojë që Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (SMC) funksionon në mënyrë efektive dhe se objektivat e tij po arrihen në praktikë. Monitorimi përbën një komponent thelbësor të ISQM 1 dhe ndihmon në identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e mangësive në sistemin e cilësisë.

Firma duhet të vendosë një proces të strukturuar të monitorimit dhe korrigjimit, me qëllim që:

- të sigurojë informacion relevant, të besueshëm dhe në kohë lidhur me projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;
- të ndërmarrë veprime të duhura për adresimin e mangësive të identifikuar, duke siguruar korrigjimin e tyre në kohë dhe në mënyrë efektive.

Firma duhet të projektojë dhe të zbatojë aktivitete monitorimi që ofrojnë bazë të mjaftueshme për identifikimin e mangësive.

Përveç mundësisë të vlerësimit të efektivitetit të sistemit të menaxhimit të cilësisë, procesi i monitorimit dhe korrigjimit kontribuon në përmirësimin proaktiv dhe të vazhdueshëm të cilësisë së angazhimeve, si dhe të vetë sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Engagement Quality Review (EQR)

Rishikimi i cilësisë së performancës së angazhimeve përbën një proces veçanërisht të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Firma ka krijuar dhe zbatuar procedura të përshtatshme për rishikimin e cilësisë në nivel angazhimi, të cilat sigurojnë një vlerësim objektiv të gjyimeve dhe vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga ekipi i auditimit gjatë zbatimit të angazhimit, si dhe të përfundimeve të arritura në procesin e përgatitjes së raportit të auditimit.

Firma përdor një metodologji dhe kritere të përshtatura nga RSM Global për klasifikimin e angazhimeve sipas nivelit të rrezikut, si në raport me ekipin e auditimit, ashtu edhe me vetë natyrën e angazhimit.

Nëpërmjet analizimit të ndërlidhjes ndërmjet këtyre dy kategorive të rrezikut, përmes një modeli të strukturuar vlerësimi, firma përcakton se për cilat angazhime kërkohet caktimi i një Rishikuesit të Pavarur të Cilësisë. Rishikimi i pavarur i cilësisë është i detyrueshëm për angazhimet e auditimit të klientëve të listuar në bursë, si dhe për subjektet me interes publik.

Rezultatet e monitorimit të cilësisë së auditimit

Rishikimet kryhen në baza vjetore si pjesë e Programit të Kontrollit të Firmave Anëtare. Çdo tre vite, inspektimi realizohet nga RSM Global. Rishikimet sigurojnë një mbulim të arsyeshëm të dosjeve, ndërsa rishikimet e dosjeve të Sigurimit të Cilësisë ("QA") përfshijnë një përzgjedhje të të llojeve dhe madhësive të klientëve, duke përfshirë edhe auditimet të specializuara, si ato në institucione financiare. Koordinatori i Inspektimit i raporton çdo vit Bordit gjetjet e inspektimit, duke identifikuar çdo çështje të rëndësishme dhe duke propozuar marrjen e masave dhe veprimeve të menjëhershme, sipas nevojës. Gjithashtu, një raport gjithëpërfshirës që përfshin gjetjet dhe planin e veprimit i paraqitet RSM Global. Në përputhje me politikën e RSM Global, Firma është inspektuar nga RSM Global në tetor 2023. Inspektimi ka përfshirë rishikimin e një mostre të dosjeve të auditimit dhe shërbimeve të tjera, si dhe vlerësimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SOQM) në nivel firme. Raporti përfundimtar i inspektimit është dërguar nga RSM Global në mars 2024 dhe nuk ka identifikuar gjetje të rëndësishme. Bordi është i angazhuar ngushtë në të gjitha vizitat rregullatore dhe shqyrton në mënyrë të detajuar të gjitha gjetjet dhe rekomandimet. Trajnimet dhe proceset tona i nënshtrohen rishikimit të vazhdueshëm, me qëllim sigurimin e standardeve më të larta të cilësisë në kryerjen e auditimeve tona.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Janë ndërmarrë veprime për adresimin e fushave për përmirësim të identifikuar në raportet e inspektimit. Ne vazhdojmë t'u përgjigjemi shqyrtimeve të fundit dhe praktikës më të mirë aktuale. Progresi në zbatimin e këtyre masave është, dhe do të vazhdojë të monitorohet nga Bordi.

Vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë

Trupi drejtues i RSM Kosovo, i cili mban përgjegjësinë kryesore për vlerësimin e efektivitetit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SQM), ka kryer vlerësimin e tij vjetor dhe ka arritur në përfundimin, në emër të firmës, se sistemi i menaxhimit të cilësisë:

a) l ofron firmës një nivel të arsyeshëm sigurie se objektivat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë po arrihen.

Rezultatet e monitorimit të jashtëm

Këshilli Kosovar për Raportim Financiar dhe Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) kryejnë monitorimin e cilësisë së auditimit të firmave dhe anëtarëve të shoqatës.

Gjatë vitit 2024, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), si organ ekzekutiv i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, ka kryer rishikimin e cilësisë së auditimit të anëtarëve të tij, ndërsa raporti i kontrollit të cilësisë i lëshuar nga BMP ka rezultuar pozitiv.



Edukimi i vazhdueshëm profesional, rekrutimi dhe zhvillimi personal

Trajnimi dhe mbështetja

Investimi në trajnimin dhe zhvillimin e stafit tonë është me rëndësi të veçantë.

RSM Campus ofron një platformë gjithëpërfshirëse edukimi, e cila përfshin një gamë të gjerë kursesh të përshtatura për nevoja të ndryshme profesionale dhe është e disponueshme për të gjithë stafin e RSM. Kjo siguron që të gjithë punonjësit në rrjet të kenë qasje në burimet më të fundit të trajnimit dhe në mundësi të vazhdueshme për zhvillim profesional.

RSM Campus është gjithashtu vendi ku anëtarët e ekipit regjistrojnë trajnimet e tyre për qëllime të Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD). Përveç kurseve në fusha kyçe si auditimi, këshillimi dhe etika profesionale, RSM Campus përfshin edhe trajnime që adresojnë fusha për përmirësim të identifikuar përmes gjetjeve të rregullatorëve, si dhe sfida të zakonshme të industrisë, përfshirë ndikimet e përditësimeve në standardet ISA, IFRS dhe FRS.

Ekipi ynë për trajnime teknike dhe zhvillim ofron një program bazë të trajnimeve në auditim dhe raportim financiar për të gjithë stafin e auditimit, me qëllim sigurimin e përditësimit të vazhdueshëm me rregulloret dhe standardet në fuqi. Përveç këtij programi bazë, ofrohen edhe trajnime shtesë të përshtatura sipas roleve dhe fushave të specializimit të partnerëve dhe stafit.

Në rastet kur identifikohen fusha që kërkojnë përmirësim në proceset e auditimit, ekipi zhvillon kurse të dedikuara për adresimin e tyre në kohë dhe në mënyrë efektive.

Një shembull i kësaj qasjeje është rritja e rëndësisë së tregut të kriptomonedhave, për të cilën janë zhvilluar trajnime specifike mbi kontabilitetin dhe auditimin e aseteve kripto, si dhe trajnime shtesë të fokusuara në auditimet e sektorit të sigurimeve.

Materialet etike janë lehtësisht të aksesueshme dhe trajnimi ofrohet për stafin në të gjitha nivelet e organizatës, duke mbuluar detyrimet etike të jashtme ndaj të cilave firma është e detyruar të përmbahet.

Trajnimi i zhvilluar gjatë këtij viti në këtë fushë është fokusuar kryesisht në ndryshimet e fundit në Kodin e Etikës të IESBA. Partnerët dhe stafi i auditimit janë informuar mbi rëndësinë e konsultimit me ekipin e etikës për çdo çështje, veçanërisht në rastet që lidhen me interpretimin e kërkesave etike, për të cilat mund të kenë paqartësi ose pasiguri.

Trajnim adekuat është ofruar edhe për standardin e ri të menaxhimit të cilësisë ISQM 2, ku stafi është njohur me kërkesat e standardit në lidhje me emërimin, përshtatshmërinë dhe përgjegjësitë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit (Engagement Quality Reviewer).

Firma gjithashtu mbulon kostot e trajnimeve dhe ofron leje studimi për ndjekjen e kurseve profesionale, përfshirë edhe për anëtarët e stafit që janë në proces të kualifikimeve profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Edukimi i vazhdueshëm profesional

Si pjesë e angazhimit tonë për cilësi, RSM ka zhvilluar një program katërvjeçar trajnimi në auditim, i strukturuar në module që mbulojnë aspekte të ndryshme të metodologjisë së auditimit. Kurrikula e programit RSM Orb përbëhet nga 75 module dhe është e disponueshme për të gjitha Firmat Anëtare të RSM përmes RSM Campus.

Partnerët përgjegjës dhe stafi i RSM Kosovo sh.p.k., përveç qasjes në RSM Campus, janë gjithashtu anëtarë të shoqatave profesionale në Kosovë, si dhe të "Association of Chartered Certified Accountants (ACCA)".

Gjatë këtij viti, shoqatat profesionale kanë organizuar disa sesione të edukimit të vazhdueshëm profesional mbi SNRF dhe përditësimet në standardet e auditimit. Për më tepër, stafit i ofrohet trajnim i mëtejshëm i përshtatur sipas roleve specifike dhe fushave të specializimit profesional

Edukimi i vazhdueshëm profesional, rekrutimi dhe zhvillimi personal

Rekrutimi

Përmes politikave dhe proceseve tona të rekrutimit dhe zhvillimit profesional, ne synojmë të tërheqim individë të talentuar dhe t'u ofrojmë atyre mundësi të vazhdueshme zhvillimi dhe aftësi profesionale, të nevojshme për ndërtimin e një karriere afatgjatë dhe të suksesshme në RSM.

Praktikat tona të rekrutimit janë të dizajnuara për të identifikuar dhe tërhequr kandidatë të talentuar përmes kanaleve të ndryshme të rekrutimit si dhe përmes punësimit direkt. Metodologjitë tona të përzgjedhjes fokusohen në vlerësimin gjithëpërfshirës të aftësive, kompetencave dhe cilësive profesionale që konsiderohen thelbësore për suksesin e një auditori në RSM.

Ne mbetemi vazhdimisht në kërkim të profesionistëve të talentuar, të kualifikuar dhe me përvojë, të cilët ndajnë vlerat dhe standardet profesionale të kompanisë sonë.

Vlerësimi

Ne kemi investuar kohë dhe përkushtim të vazhdueshëm për të siguruar që punonjësit tanë të kenë qartësi të plotë mbi pritjet dhe përgjegjësitë në çdo fazë të zhvillimit të tyre profesional, duke u mundësuar atyre të kuptojnë rrugën e avancimit në karrierë. Përcaktimi i qartë i kompetencave për secilin nivel të stafit kontribuon gjithashtu në sigurimin e një niveli të qëndrueshëm dhe cilësor të shërbimeve për klientët tanë, pavarësisht nga vendndodhja apo ekipi i angazhuar. Çdo punonjësi nënshtrohet proceseve të rregullta të vlerësimit dhe ofrimit të feedback-ut profesional. Në fund të çdo viti, firma realizon vlerësimin vjetor të performancës, përmes të cilit rishikohet progresi ndaj objektivave të përcaktuara më parë. Cilësia e auditimit përbën një element thelbësor të çdo procesi vlerësimi të performancës.

Gjatë procesit të vlerësimit diskutohen gjithashtu trajnimet dhe programet zhvillimore të ndjekura (EVP), si dhe progresi profesional dhe zhvillimi individual i secilit punonjësi, sipas rastit.

Procesi i promovimit iniciohet përmes rekomandimeve të udhëheqësit të departamentit përkatës, bazuar në performancën, kompetencat dhe kontributin profesional të individit. Vendimi përfundimtar merret nga Bordi, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të raportit dhe rekomandimeve të paraqitura nga drejtuesi i departamentit përkatës.

Zhvillimi personal

Zhvillimi i njerëzve tanë është një prioritet i rëndësishëm për RSM. Ne ofrojmë një gamë të gjerë programesh të zhvillimit profesional dhe personal, të dizajnuara për të mbështetur individët në çdo fazë të karrierës së tyre.

Këto programe përfshijnë një shumëllojshmëri kursesh dhe mundësish trajnimi që u mundësojnë punonjësve të përshtatin zhvillimin e tyre profesional sipas nevojave individuale, si në rolin e tyre aktual ashtu edhe gjatë avancimit në role të ndryshme përgjatë karrierës së tyre.

Kompania është e përkushtuar në zhvillimin e një kulture mentorimi dhe në mbështetjen si të mentorëve ashtu edhe të anëtarëve të rinj të stafit, me qëllim që kjo marrëdhënie të funksionoj. Ne besojmë se çdo punonjësi duhet të ketë një person referues brenda organizatës, përtej menaxherit të drejtpërdrejtë, i cili ofron udhëzim dhe mbështetje në zhvillimin e karrierës së tij profesionale.

Trajnimi përbën një element thelbësor në zbulimin dhe zhvillimin e potencialit të stafit tonë, duke kontribuar në maksimizimin e performancës individuale dhe në suksesin afatgjatë të kompanisë. Për këtë qëllim, ne ofrojmë trajnime në vendin e punës për zhvillimin e aftësive dhe kompetencave në role ekzistuese, trajnime për mbështetjen e avancimit në karrierë, si dhe trajnime të fokusuara në sjellje profesionale, të cilat synojnë të nxisin ndryshime të qëndrueshme përmes rritjes së vetëdijes dhe zhvillimit personal.

Kompensimi i Partnerëve

Ne besojmë se cilësia e auditimit arrihet dhe ruhet më së miri përmes promovimit të një kulture profesionale ku partnerët dhe drejtuesit e kompanisë e konsiderojnë cilësinë e auditimit si parim themelor të çdo angazhimi, veprimtarie dhe vendimmarrjeje.

Performanca e një drejtori vlerësohet në bazë të rolit individual, kontributit profesional dhe nivelit të përputhshmërisë me standardet profesionale dhe kërkesat e cilësisë.

Partnerët dhe drejtorët e Kompanisë kompensohen përmes pagave dhe bonuseve të performancës, ku komponenti i bonusit përcaktohet mbi bazën e një vlerësimi të strukturuar, të lidhur ngushtë me kriteret e cilësisë së auditimit, si në vlerësimin e performancës së periudhës së kaluar, ashtu edhe në përcaktimin e objektivave për vitin pasues.



Auditimi i subjekteve me interes publik

RSM Kosovo gjatë vitit financiar 2025 ka kryer auditimet e mëposhtme të pasqyrave financiare të subjekteve me interes publik.

Nr.	Emri i klientit	Industria	Për vitin e përfunduar
1	Hib Petrol Sh.p.k	Tregti dhe shërbime	31 dhjetor 2024
2	Buçaj Sh.p.k.	Tregti dhe shërbime	31 dhjetor 2024
3	Birra Peja Sh.a	Prodhim	31 dhjetor 2024
4	HIB Holding Sh.p.k	Holding	31 dhjetor 2024
5	Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S Dega në Kosovë	Banka	31 dhjetor 2024
6	Turkiye IS Bankasi A.S. Dega në Kosovë	Banka	31 dhjetor 2024
7	Banka Ekonomike Sh.a	Banka	31 dhjetor 2024
8	Finca	Microfinanca	31 dhjetor 2024
9	Cash Plus Sh.a	IFJB	31 dhjetor 2024
10	RroniFer Sh.p.k	Prodhim	31 dhjetor 2024
11	Hib Coproration Sh.p.k	Tregti dhe shërbime	31 dhjetor 2024
12	Noa Energy Trade SHPK Dega në Kosovë	Energji	31 dhjetor 2024

*Shpalosja në përputhje me nenin 10, paragrafi 5.6 i ligjit nr. 06/L –032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Shënimet Financiare

Në tabelen më poshtë janë të prezantuarat të hyrat e Kompanisë të realizuara gjatë vitit 2025:.

	2025 (EUR)
Shërbimet e auditimi- (SiP)	174,522
Shërbimet e auditimi- (Jo SiP) , shërbime tjera të sigurisë dhe shërbime të ndërlidhura	191,396
Shërbimet e kontabilitetit, taksave dhe konsulencës	211,083
	577,001

Përputhja me Kërkesat e Transparencës

Tabela e mëposhtme tregon se ku trajtohet secila nga kërkesat e nenit 10 të Ligjit nr. 06/L-032 brenda këtij Raporti të Transparencës.

Kërkesa (neni 10, paragrafi 5)	Seksioni në raport
Forma ligjore dhe struktura e pronësisë	Struktura Ligjore dhe Pronësia
Përshkrimi i rrjetit dhe marrëdhëniet strukturore	Rrjeti RSM International
Struktura e qeverisjes dhe udhëheqjes	Struktura Ligjore dhe Pronësia / Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
Sistemi i brendshëm i kontrollit të cilësisë (ISQM 1)	Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
Deklarata mbi efektivitetin e sistemit të cilësisë	Shtojcë – Deklarata e Bordit
Data e fundit e rishikimit të kontrollit të cilësisë	Rezultatet e monitorimit
Lista e subjekteve me interes publik të audituara	Auditimi i subjekteve me interes publik
Pavarësia dhe konfirmimi i pavarësisë	Deklarata e Pavarësisë
Edukimi i vazhdueshëm profesional	Edukimi i vazhdueshëm profesional
Baza e shpërblimit të partnerëve	Kompensimi i Partnerëve
Informacioni financiar	Shënimet Financiare

SHTOJCA

Deklaratë e Bordit të Partnerëve
për efektivitetin e funksionimit të
sistemit të kontrollit të cilësisë

Deklarata e pavarësisë

Deklarata mbi edukimin e
vazhdueshëm profesional


Deklaratë e Bordit të Partnerëve për efektivitetin e funksionimit të sistemit të kontrollit të cilësisë

Gjatë vitit 2025, RSM Kosovosh.p.k. ka vazhduar të investojë në forcimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të saj të brendshëm të menaxhimit të cilësisë, në përputhje të plotë me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë 1 (ISQM 1). Gjatë vitit, kemi zbatuar një kuadër të qëndrueshëm të menaxhimit të cilësisë, i cili mbështet ofrimin e shërbimeve të besueshme, me integritet dhe me cilësi të lartë.


Sistemi ynë mbulon të gjithë komponentët kyç të ISQM 1, përfshirë: qeverisjen, liderhipin, etikën dhe pavarësinë, pranimin dhe vazhdimësinë e klientëve, performancën e angazhimeve, burimet (njerëzore, teknologjike dhe metodologjike) si dhe proceset e monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Për të siguruar efektivitetin e vazhdueshëm të sistemit, gjatë vitit 2025 janë kryer rishikime të brendshme të angazhimeve të përfunduara, janë analizuar shkaqet rrënjësore të mangësive të identifikuara dhe janë ndërmarrë masa përmirësuese aty ku është konsideruar e nevojshme. Këto masa janë mbështetur me trajnime të rregullta për stafin, përditësime të metodologjisë së auditimit, si dhe me përdorimin e teknologjive mbështetëse që kontribuojnë në forcimin e pajtueshmërisë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve tona.

RSM Kosovosh.p.k. konfirmon se, bazuar në njohuritë dhe bindjen e saj më të mirë, sistemi i menaxhimit të cilësisë ka funksionuar në mënyrë efektive gjatë vitit që ka përfunduar më 31 dhjetor 2025, duke ofruar një nivel të arsyeshëm sigurie se angazhimet janë kryer në përputhje me kërkesat ligjore, rregullatore dhe profesionale në fuqi.



Visar Morina
Partner Menaxhues




Sadik Berisha
Kryetar i Bordit


Deklarata e Pavarësisë

RSM Kosovo sh.p.k. konfirmon se ka zhvilluar dhe zbatuar politika dhe procedura të brendshme me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me kërkesat e Kodit të Etikës së IESBA për Kontabilistët Profesionistë, të lëshuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), si dhe me kërkesat përkatëse rregullative vendore. Këto politika dhe procedura janë hartuar për të mbështetur dhe ruajtur standardet më të larta të pavarësisë, integritetit dhe sjelljes etike në të gjitha angazhimet profesionale të firmës.

Gjatë vitit 2025, këto politika dhe procedura janë zbatuar dhe monitoruar në mënyrë të vazhdueshme, duke siguruar që të gjithë partnerët dhe anëtarët e ekipeve të angazhimeve të respektojnë standardet e kërkuara të pavarësisë dhe pajtueshmërisë etike. Në kuadër të këtij procesi, janë kryer rishikime të rregullta të brendshme dhe vlerësime të strukturuar për identifikimin dhe adresimin në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme të çdo kërcënimi të mundshëm ndaj pavarësisë.



Visar Morina
Partner Menaxhues




Sadik Berisha
Kryetar i Bordit

Deklarata mbi edukimin e vazhdueshëm profesional


Gjatë vitit 2025, RSM Kosovo sh.p.k. ka zbatuar në mënyrë të vazhdueshme politikën e saj për edukimin e vazhdueshëm profesional, me qëllim të ruajtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të kompetencave të auditorëve të licencuar dhe stafit të auditimit.

Kjo politikë është në përputhje me kërkesat e standardeve profesionale ndërkombëtare dhe rregulloreve vendore, duke synuar përditësimin e njohurive teknike, aftësive profesionale dhe vlerave etike të personelit tonë.

RSM Kosovo sh.p.k. konfirmon se gjatë vitit 2025, ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në politikat dhe procedurat e saj për edukimin e vazhdueshëm të partnerëve dhe stafit të përfshirë në angazhimet e auditimit.



Visar Morina
Partner Menaxhues



Sadik Berisha
Kryetar i Bordit

RSM KOSOVO SH.P.K

Str. Xhevdet Doda, Dukagjini Residence,
Hyrja B-C, Kati 2, Nr. B56,
Prishtina, Republic of Kosovo
T +383 45 666 888
Email: info@rsmks.com
www.rsmks.com

RSM KOSOVO SH.P.K is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

The network is administered by RSM International Limited, a company registered in England and Wales (company number 4040598) whose registered 200 Aldersgate Street, London, EC1A 4HD, United Kingdom. The brand and trademark RSM and other intellectual property rights used by members of the network are owned by RSM International Association, an association governed by article 60 et seq of the Civil Code of Switzerland whose seat is in Zug.

© RSM International Association, 2026